

PROCESVERBAL – Tipi i kontrates - Sherbime

PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM

(Ky procesverbal eshte per efekt publikimi bashke me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURES: *“Blerje Licence 1 Vjecare, UpGrade i Programit te Flare Billing dhe Programi i Fiskalizimit per nevojat e SHRUKK”*

KODI PERKATES NE FJALORIN E PERBASHKET TE PROKURIMIT (CPV):
Sherbimet e lidhura me softwaret - 72260000-5.

Ne baze te nenit 21, pika 2, te Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, te V.K.M. nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Gjirokaster sh.a ka hartuar procesverbalin per argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve per kualifikim per proceduren e sipercituar, me permbajtjen si me poshte;

2. KRITERET E VEÇANTA TE KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet te paraqese:

- a. Formularin e ofertes , sipas shtojces 1
- b. Listen e cmimeve te sherbimeve , sipas shtojces 2
- c. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 9
- d. Sigurimin e Ofertes, sipas Shtojces 3;

Argumentimi: *Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me nenin 82 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” dhe neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te ligjit nr.162/2020, “Per Prokurimin Publik” si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-se nr.285, date 19.5.2021, “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik: citojme neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet te kerkoje paraqitjen e sigurimit te ofertes nga ofertuesit ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit, me perjashtim te procedurave te prokurimit me vlere te vogel”, neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.*

2.1 Kapacitetin profesional te operatoreve ekonomike:

Sipas kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit, (Shtojca 9)

Operatori duhet te kete te perfshire ne objektin e veprimtarise ne Ekstraktin e QKB edhe objektin e prokurimit te kesaj kontrate.

Ofertuesi duhet te deklaroje se permbush kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit. Keto kritere duhet te plotesohen me dorezimin e vetedeklarates me shkrim te subjektit, ne ditën e hapjes se ofertes, sipas Shtojces 9.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme bazohet ne nenin 77, pika 1/a dhe 2, te LPP, nenit 41, pika 5, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", si dhe shtojces 9 te DST-se.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatoret ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per 3 vitet e fundit financiare (2021,2022,2023) ku vlera e xhiros minimale vjetore per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 40% e vleres se parashikuar te kontrates. Kerkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure, si dhe nenin 77, pika 3, te LPP, si dhe nenin 43, pika 2/b, neni 55 pika 4 germa b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

Percaktimi i vleres se kerkuar argumentohet si me poshte: "Vlera e xhiros minimale vjetore qe u kerkohet operatoreve ekonomike nuk mund te tejkaloje:

.... 40 % te vleres se parashikuar te kontrates, ne procedurat e prokurimit nen kufirin e ulet monetar". Kjo procedure eshte nen kufirin e ulet monetar dhe per kete arsye, vlera e xhiros minimale te kerkuar, eshte brenda kufirit te parashikuar ne dispozitat ligjore te sipercituara....

Si dhe neni 55/4....." Ne kete lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet te mbajne ne konsiderate te percaktojne kritere te thjeshtuara pranimi, me qellim nxitjen e pjesemarrjes se biznesit te vogel dhe te mesem.

Kerkesat ekonomike financiare duhet te kerkohen ne raport me objektin e prokurimit, duke marre ne konsiderate qe plotesimi i ketyre kerkesave mund te behet vetem me paraqitjen e xhiros vjetore te realizuar nga operatoret ekonomike. Vlera e xhiros se kerkuar ne kete lloj procedure prokurimi nuk mund te tejkaloje 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates, sipas parashikimeve ne nenin 43, te ketyre rregullave."

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e vertetimit te xhiros vjetore eshte bere bazuar ne nenin 43, pika 2/b, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", si dhe ne legjislacionin e fushes ne fuqi, perkatesisht ne Ligjin nr. 8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 date 29.12.2014 "Per deklarimin e

detyrueshem te deklarave tatimore dhe te dokumenteve te tjera tatimore, vetem nepermjet formes elektronike", si dhe ne Udhезimin e Ministrit te Financave nr.5, date 30.01.2006, "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar. Ne çdo rast, kerkesa per plotesimin e kapaciteteve financiare do te konsiderohet e permbushur nese operatoret ekonomike arrijne vleren e xhiros minimale, ne te pakten nje vit te periudhes se kerkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2. Pasqyrat financiare per vitet (2021,2022, 2023) te konfirmuara nga administrata tatimore. Ne rast se operatori ekonomik eshte ne kushtet e percaktimeve te nenit 41, te ligjit nr.10091, date 05.03.2009, atehere bilancet duhet te shoqerohen edhe me raportet e auditimit ligjor te pasqyrave financiare vjetore, te kryera, nga auditues ligjore ose shoqeri audituese. Kriteri konsiderohet i permbushur nese ne bilancet e kerkuara nuk ka raport negative ndermjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e bilanceve eshte bere duke iu referuar legjislacionit te fushes, konkretisht, ne Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme mbeshtetet ne Nenin 77, pika 3, te Ligjit Nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik"; si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik". Percaktimi i viteve te kerkuara per paraqitjen e bilanceve eshte bere duke iu referuar legjislacionit te fushes, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar" (i ndryshuar).*

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Furnizime te meparshme te ngjashme me nje vlere jo me te ulet 40% te fondit limit te objektit te prokurimit, te realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, vertetuar me dokumentacionin vertetues si me poshte:

- per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlera, afati i perfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, ku shenohen datat, shumatat dhe sherbimet e realizuara.
- per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet te paraqese fatura tatimore te shitjes, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku shenohen datat, shumatat dhe sherbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kerkesa e mesiperme eshte percaktuar bazuar ne nenin 77 te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 dhe neni 55 pika 4 germa b), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik"Per kontratat e mallrave dhe sherbimeve vlera totale e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te vogel se 20% te*

vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten, prandaj eshte kerkuar qe sherbimet e meparshme te ngjashme te jene ne vleren jo me pak se 40 % te vleres se fondit limit, qe eshte brenda vleres kufi te percaktuar ne nenin e sipercituar.

Percaktimi i vleres se kerkuar per kontratat e ngjashme eshte vendosur brenda kufirit te vleres te percaktuar ne rregullat e prokurimit publik dhe i sherben AK per te treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kane realizuar kontrata te ngjashme me objektin qe prokurohet, ne vlere jo me te vogel se 40 % te fondit limit, ne afat, me cilesi dhe rrit besueshmerine mbi pervojen qe ka ofertuesi ne treg. Pervoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbesor dhe si rrjedhim operatoret ekonomike duhet te paraqesin deshmi te tilla si referenca/fatura tatimore, per te provuar kryerjen e tyre qofte me sektorin privat dhe ate publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

- a) ISO 9001 (ose ekuivalente) (për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë)
- b) ISO 27001 (ose ekuivalente) (për Sigurinë e Informacionit)

Argumentim: Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra,

shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

a) ISO 9001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të cilësisë:

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) ISO 27001 (ose ekuivalente), për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit:

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.

- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të dorzojë një dokument nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për shitjen e licensave dhe softwareve të ofruar për këtë procedurë prokurimi, ku dokumenti të përmbajë dt. e sakte dhe nr e references së kësaj procedure dhe gjithashtu dhe kontaktin e leshuesit të këtij dokumenti në rast të verifikimit.

Argumentimi: Sipas specifikimeve teknike ku kerkohet një produkt i gatshëm si në licence, upgrade dhe implementim të procesit të fiskalizimit, kërkesa e mesipërme është dokument që garanton autoritetin kontraktor mbi origjinalitetin dhe mbështetjen e prodhuesit për procedurën që do të prokurohet. Me anë të këtij autorizimi operatori ekonomik garanton të drejtën për të nderhyre në kodin burim të cilin autoriteti nuk e disponon dhe gjithashtu është i suportuar nga prodhuesi për çdo anomali apo situatë që mund të ndodhë gjatë procesit të upgrade dhe implementimit të fiskalizimit duke e kthyer sistemin në gjendjen e mëparshme brenda 24 orëve për të mos sjelle ngrerje në proceset e punës të shoqërisë. Gjithashtu kjo mardhenie Prodhues/Distributor i Autorizuar me Operatorin Ekonomik garanton Autoritetin Kontraktor për sigurinë e të dhënave të abonenteve që janë edhe sensitive ashtu dhe me një historik prej 14 vjetësh. Dështimi i Upgrade, implementimit dhe integritetit të procesit të fiskalizimit do sillte pasoja të rënda në pasqyrat financiare të shoqërisë dhe në mardhëniet me autoritetet eprorë të cilat vendosin mbi projektet buxhetet e shoqërisë deri në falimentimin e shoqërisë. Gjithashtu të gjithë elementet që janë përfshirë në këtë procedurë kanë të bëjnë dhe me mardhënien e shoqërisë me abonentin duke filluar që në hedhjen e të dhënave për të deri tek gjenerimi i sakte i fatures.

Ky kriter është jo diskriminues, është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për produktet software ose komponentet që ofrohen falas nga prodhuesi të cilat vetëm shpërndahen por nuk shiten, nuk është i nevojshëm autorizimi por mjafton që OE të permende emrin e komponentit, burimin ku do ta marrë psh website zyrtar, dhe një burim në internet ose dokument të vertetueshëm nga AK ku përcaktohet që prodhuesi ose distributori i saj e ofron falas dhe lejon shpërndarjen për kedo.

2.3.4 Per te vertetuar qe ka kapacitete njerezore, profesionale te mjaftueshme per realizimin ne kohe dhe sipas specifikimeve teknike te projektit, operatori ekonomik duhet te kete te punesuar punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), te cilet ne menyre te kombinuar, te plotesojne kerkesat per certifikime si me poshte:

Argumentimi: Kjo kerkese vendoset ne mbeshtetje te nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore percaktojne kerkesat per kualifikim per operatoret ekonomike bazuar ne:

a) pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftesine teknike dhe profesionale

Per realizimin e ketij sherbimi kerkohet qe ne secilen nga fushat kryesore te projektit, operatori ekonomik te perdori punonjes teknik ne numer te mjaftueshem dhe te kualifikuar. Fushat e mesiperme te ekspertizes dhe certifikimit te punonjesve, jane kryer ne baze te komponenteve te projektit si dhe te mases se angazhimit te specialisteve. Diplomimi i punonjesve eshte kerkuar ne perputhje me objektin e prokurimit dhe termat e references pasi ky objekt prokurimi perfshin implementimin, adaptimin, testimin, migrim dhe instalimin e te gjitha informacioneve teknike te sistemit. Ne e kemi shume te nevojshme realizimin ne kohe te shkurter te kontrates. Ne jemi te bindur qe nese OE qe ploteson kapacitet e kerkuara te pergjithshme e te vecanta dhe ve ne dispozicion punonjes me diplomimin dhe certifikimet sic do te vijoje ne vazhdim ateher mund te arrije te gjitha kerkesat e kerkuara prej nesh.

a. Te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar per zhvillim ne zgjidhjen software te ofruar.

Argumentim: Duke pasur parasysh qe procedura qe kerkohet te prokurohet ka te beje me shume procese kritike te shoqerise duhet qe operatori ekonomik te garantoje me ane te burimeve njerzore te certifikuar per sherbimet qe do te ofroje. Sipas specifikimeve teknike upgrade, integrimi dhe implementimi i procesit te fiskalizimit kerkohen te realizohen ne nje periudhe pese ditore per te mos nderprere vijueshmerine e procese dhe gjithashtu keto ndryshime dhe implementime nuk duhet te sjellin pasoja te parikuperueshme ne te dhenat e shoqerise. Gjithashtu keta dy punonjes do te garantojne pergjate periudhes se kontrates qe te gjitha anomalite, update-tet e ndryshme te komponenteve qe perdor ky sistem, anomalite ne procesin e fiskalizimit si hap te fundit te gjenerimit te fatures, do te jene te zgjidhura ne kohe sipas SLA te percaktuar ne specifikimet teknike gje e cila do te sillte nje performance te kenaqshme te shoqerise kundrejt autoriteteve me te cilat ajo ka mardhenie. Per arsyet e mesiperme behet shume e domosdoshme qe te pakten dy punonjes te jene te certifikuar ne zgjidhjen e ofruar per te mos u ekspozuar si shoqeri sipas parashikimeve ne paragrafin supozimet dhe risqet.

Me ane te ketyre dy punonjesve do te garantohej ne rradhe te pare qe te gjitha prishmerite nga ana e Autoritetit Kontraktor per sa i perket funksionalitetve ne sistem pas Upgrade sic jane parashikuar ne specifikimet teknike, ndjekjen e proceseve njeri pas tjetrit deri ne fiskalizimin e faturave dhe suportimin e stafit per cdo suate.

b. Te pakten 1 (nje) punonjes të çertifikuar për arkitektura service-oriented (SOACP ose ekuivalente).

Argumentim: Nisur nga shërbimet që ofron integrimi me palët e treta dhe procesin e fiskalizimit, shërbimet që do të mirëmbahen dhe siguria e tyre është e domosdoshme që operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij një punonjës të certifikuar për arkitektura service-oriented (SOACP ose ekuivalente). Ky punonjës do të ofronte dhe garantonte një mardhenie profesionale dhe të sigurt me të gjithë palët e treta me cilat shoqëria ka marrveshje apo do të lidhe marrveshje në të ardhmen për pagesat online si dhe me mirembajtjen e integritet të procesit të fiskalizimit. Ky person do të ofrojë që nga URL përkatëse, Kredencialet autentifikues, sistemin test, API-n për integrim dhe do të bashkërendojë punën deri në implementim të plotë me palën e tretë që do të kryej shërbimin, dhe integrimin me procesin e fiskalizimit. Gjithashtu ky punonjës do të ofrojë suport për çdo situatë që mund të ndodhë gjatë këtyre shërbimeve të cilat janë shumë fundamentale për shoqërinë. Për të gjitha detyrat specifike që u përmenden me sipër certifikimi i këtij punonjësi do të garantonte shoqërinë maksimalisht për këtë proces që ka të bëjë direkt me një mardhenie financiare shumë dinamike. Këto shërbime duhet të jenë njëkohësisht edhe të sigurt për të garantuar saktësinë dhe privatesinë e të dhënave që shkëmbehen. Për të gjithë arsyet e mësipërme AK ka vendosur kriterin e mësipërm.

c. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per menaxhimin e ofrimit te sherbimeve ITIL ose ekuivalente

Argumentim: Kjo kërkesë lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave të shprehura në specifikime teknike ku përcaktohen kohët e sakta të nderhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit SLA (shërbimet e mirembajtjes) si dhe zgjidhjet e problemeve. Një certifikim ITIL është kuader rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të projektit të autoritetit kontraktor. Kjo kërkesë i garanton autoritetit kontraktor që operatori ekonomik (nëpërmjet stafit të certifikuar si me sipër, garanton kordinimin e shërbimeve IT të projektit, menaxhimin e tyre, duke zbatuar SLA sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe suportin e stafit në situata të ndryshme të cilat që janë shumë të rëndësishme për AK dhe të vëna në dukje në specifikimet teknike.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetedeklarimit sipas shtojcës 9. Përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit OE i kualifikuar në vend të parë për të vertetura disponimin e punonjësve të mësipërm duhet të paraqesë dokumentacionin si mëposhtë:

- **Formulareve E-SIG për periudhën e 3 muajve të fundit duke iu referuar datës së shpalljes së procedurës**
- **Certifikatat/transkriptet që vertetojnë certifikimet e mësipërme të kërkuara**
- **Diplomat e shkollës së lartë**

Një punonjës mund të disponojë me shumë se një certifikim.

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane stafin, personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet te jete i licensuar nga A.K.SH.I. dhe D.P.T. per ofrim zgjidhje software per fiskalizim.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme vjen ne baze te ligjit 87/2019 date 18.12.2019 PËR FATURËN DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT, per te garantuar qe operatori ekonomik eshte i licensuar nga Autoritet perkatese per procesin e fiskalizimit proces i cili permbyll te gjithë ciklin e gjenerimit te fatures, e cila sjell dhe mundesine e arketimit te vlerave financiare per shoqerine.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet te jete i certifikuar nga ofruesi i sherbimit Cloud ku do te aksesohet dhe do te funksionojë software gjate kohezgjatjes se kontrates ose te kete partneritet zyrtar me te. Te dorezohet nje dokument i vlefshem i leshuar nga ofruesi i sherbimit Cloud ose te jete i verifikueshem ne website zyrtar te ofruesit te sherbimit Cloud.

Argumentimi: Kerkesa e mesiperme vjen se rrjedhoje ne zbatim to Ligjit Nr. 2/2017, "Per Sigurine Kibernetike", si dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 553, date 15.07.2020, "Per miratimin e listes se infrastrukturave kritike te informacionit dhe te listes se infrastrukturave te rendesishme te informacionit", i ndryshuar, ligjit Nr. 25/2024. Cdo SHRUK eshte percaktuar, si operator i infrastrukturave kritike dhe e rendesishme e informacionit. Per kete arsye, ne mungese te nje infrastrukture dhe burimeve njerzore nga ana e shoqerise kerkohet qe operatori ekonomik te garantoje me ane te nje dokumenti qe eshte i certifikuar ose partner zyrtar i Cloud-it ku operon dhe mirembahet sistemi dhe back-up-et e tij per te garantuar AK per kapacitetin e provuar te OE lidhur me shfrytezimin e Cloud-it. Per ne eshte garanci e shtuar qe OE ka certifikim ose partneritet me ofruesin e sherbimit Cloud pasi kjo tregon vleresimin dhe konfirmimin per kapacitetet qe OE zoteron per te arritur ate status.

Argumentimi i specifikimeve teknike dhe termave te references:

Specifikimet teknike jane hartuar nga struktura te specializuara/ Grup pune per objektin qe prokurohet, i ngritur me Urdher te Titullarit per hartimin e specifikimeve teknike/ termave te referencave, ne perputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, te LPP, si dhe nenit 41, pika 1, te VKM nr. 285, date 19.05.2021, “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kerkese funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard te kerkuar**, ku çdo reference duhet te shoqerohet nga fjalet “ose ekuivalenti i tij/saj”.

NJESIA E PROKURIMIT